



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.27, datë 30.04.2007

**MBI**

**CAKTIMIN E TERRITORIT TË PARKUT TË MADH TË LIQENIT ARTIFICIAL  
SI ZONË ME TRAFIK TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", Ligjit Nr.8908, datë 06.06.2002 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", Ligjit Nr.9096, datë 03.07.2003 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.8738, datë 12.02.2001 "Për një shtesë në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", Ligjin Nr.9198, datë 12.02.2004 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" neni 5, neni 6 dhe neni 7, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Transporteve Nr.5781, datë 23.12.2003, me ndryshimet përkatëse, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të caktojë territorin e Parkut të Madh të Liqenit Artificial, si zonë me trafik të kufizuar.
2. Bashkia e Tiranës të pajisë me lejekalimet përkatëse, të gjitha rastet e qarkullimit të domosdoshëm brenda territorit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial, për shkak të rrethanave që nuk mund të përjashtohen. Për këto raste qarkullimi do të jetë i organizuar sipas planit të lëvizjes dhe orareve të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Transportit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit që në bashkëpunim me Organet e Qarkullimit Rrugor të marrin masat për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**SOKOL DERVISHAJ**